



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 462/5 Prot.

Tiranë, më 20.07.2018

V E N D I M

Nr.72, datë 20.07.2018

**MBI PËRFUNDIMIN E VERFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË
NËPËRMJET KËRKESËS SË PUNONJËSES ***** , PROTOKOLLUAR ME NR.
462 PROT., DATË 22.5.2018.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së hetimit administrativ,

VËREJ SE :

Me anën e kërkesës së regjistruar menr. 462 prot., datë 22.5.2018, punonjësja ***** , e cila ka kryer detyrën “Inspektor”, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Bashkisë Pogradec, informon se, me vendimin nr. 83, datë 11.5.2018, të njësisë së burimeve njerëzore, ajo është liruar nga shërbimi civil me arsyetimin se, me ndryshimin e strukturës, pozicioni i saj i punës është shkurtuar.

Punonjësja në fjalë, pretendon se, vendimi i mësipërm, ka dalë në kundërshtim me pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në rastin konkret, nuk ka patur shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe nga ana tjetër, nuk është parë mundësia e sistemimit të saj në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ku ajo plotëson kriteret dhe se dëmshpërblimi i dhënë, nuk është llogaritur në përputhje me vjetërsinë e saj si nëpunëse civile.

Duke u nisur nga sa më sipër, Komisioneri, vendosi të verifikojë këtë rast, duke bërë njoftimin e institucionit nëpërmjet shkresës nr. 462/2 prot., datë 24.5.2018, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit të kërkesës të punonjësës *****, në lidhje me lirim të saj nga shërbimi civil”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Pogradec.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e institucionit, me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 30.5.2018, “Kthim përgjigje kërkesës suaj”(protokolluar pranë Komisionerit me aktin nr. 462/3 prot., datë 4.6.2018), është dërguar dokumentacioni që materializon procesin e ristrukturimit dhe lirim të punonjësës ***** për shkak të këtij procesi.

Nga analiza e përmbajtjes së këtyre akteve rezulton se, punonjësja ***** është punësuar pranë Bashkisë Pogradec që nga viti 1998 e në vazhdim, pa ndërprerje, duke përfutur statusin e nëpunësit civil, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (data 26.2.2014), kjo punonjësja ka qenë në pozicionin “Specialiste e nivelit të lartë për produktet veterinarë”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit e për këtë arsye, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të nenit 67, të ligjit në fjalë, njësisia përgjegjëse me aktin nr. 4, datë 13.6.2014, e ka deklaruar/konfirmuar “nëpunës civil” në atë pozicion.

Pas miratimit të strukturës dhe organikës për vitin 2016, me Vendimin nr. 129, datë 21.4.2016, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec”, për shkak të riorganizimit të Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit, punonjësja ***** është sistemuar në pozicionin “Inspektor”, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Bashkisë Pogradec.

Nga përmbajtja e akteve, rezulton se këtë detyrë, ajo e ka kryer deri në momentin kur, me aktin nr. 29, datë 1.3.2018, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi”, është miratuar struktura e institucionit për vitin 2018, ku, ndër të tjera, pozicioni i punës, “Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Konsumatorit”, është shkurtuar dhe për këtë arsye, me Vendimin nr. 83, datë 11.5.2018, të njësisë së burimeve njerëzore, nëpunësja në fjalë është liruar nga shërbimi civil.

Nga krahasimi i strukturave konstatohet se, Inspektorati i Mbrojtjes së Konsumatorit, për vitin 2017, ka qenë i organizuar me **1** Përgjegjës Zyre dhe **3** Inspektorë të Mbrojtjes së Konsumatorit (ku kryente detyrën kërkuesja), ndërsa me miratimin e strukturës për vitin 2018, rezulton të jetë organizuar vetëm me **2** Inspektorë të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Shkurtimi i pozicioneve të punës në këtë sektor, si dhe nënjësitë administrative, sipas përshkrimit të punës që kryente ky pozicion, ka ardhur si pasojë e mbylljes së thertoreve në territorin e Bashkisë Pogradec, në bazë të një Urdhëri të Ministrisë së Bujqësisë dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në Tetor të vitit 2017. Pra, në kushtet e reja, institucioni i Bashkisë Pogradec, ka qenë i detyruar të reflektojë në strukturën e tij, duke shkurtuar pozicionet e panevojshme të punës, gjë e cila do të shoqërohej dhe me ristrukturimin e njësive organizative që mbulonin këtë sektor.

Nga sa më sipër, rezulton se, ky shkurtim i detyruar i disa prej pozicioneve të punës do të diktonte procesin e ristrukturimit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe pikës 13, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë” si dhe të Udhëzimit nr.1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”.

Për këtë qëllim, me Vendiminnr. 47, datë 30.3.2018, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit, i cili kishte detyrën të shqyrtonte mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe të bënte propozimin përkatës për transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin na i plotëson kërkesat specifike, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” indryshuar.

Komisioni i Ristrukturimit, sipas përmbajtjes së relacionit datë 2.5.2018, drejtuar njësisës menaxhimit të burimeve njerëzore, ka sqaruar se, pas konstatimit që pozicioni i punës që mbante punonjësja *****, “Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Konsumatorit” ishte shkurtuar, ka shqyrtuar dosjen personale të nëpunëses *****, për të vlerësuar mundësinë e sistemimit të saj në ndonjë nga pozicionet e lira të mbetura apo krijuara pas ristrukturimit. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit, ka arritur në konkluzionin se, sistemimi i saj ishte i pamundur, pasi nuk kishte vend të lirë pune që të përkonin me përshkrimin e punës “Inspektor Veteriner”, në shkenca Veterinare, brenda institucionit të bashkisë, në ndërmarrjet që janë në varësi të bashkisë apo në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Për këto arsye, në këtë rast, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke i njohur nëpunëses të drejtat e përcaktuara në pikat 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë dhe e drejta e konkurrimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, brenda një periudhe dy vjeçare, kur konstatohet një pozicion i lirë brenda shërbimit civil.

Por, pavarësisht se Komisioni i Ristrukturimit ka zbatuar me korrektesë kërkesat e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kur ka arritur në përfundimin për pamundësinë sistemimit të punonjësës *****, në ndonjë nga pozicionet e mbetura apo krijuara pas ristrukturimit të institucionit, nëvendimin e tij, konstatohet një moment i zbatimit të gabuar të ligjit material. Konkretisht, në pikën 3, të vendimit nr.83, datë 11.5.2018, të njësisë së burimeve njerëzore, me të cilin është liruar nga shërbimi civil punonjësja *****, është përcaktuar e drejta e shpërblimit të punonjësës në masën 6 muaj pagë, sipas shkronjës “c”, pika 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Nga përmbajtja e akteve të administruara konstatohet se, punonjësja *****, ka punuar pranë Bashkisë Pogradec që nga viti 1998 dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, punonjësja *****, ka përfutuar statusin nëpunës civil, (me aktin datë 31.5.2002), cilësi që e ka gëzuar pa ndërprerje, deri në momentin e lirimit nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën “d” të nenit 109 dhe pikën 3, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”, akti nr.83, datë 11.5.2018, i njësisë së burimeve njerëzore, me të cilin është liruar nga shërbimi civil punonjësja *****, duhet të ndryshohet në pikën 3, të tij, duke u saktësuar dëmshpërblimi i saj në përputhje me vjetërsinë në punë si nëpunës civil mbi 9 vjet, në vlerën e 12 pagave, siç parashikohet prej shkronjës “d”, të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” e nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Pogradec, që në bazëtë pikës 3, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të drejtojë procesin administrativ tëndryshimit të pikës 3, të aktit të lirimit nga shërbimi civil nr. 83, datë 11.5.2018, duke e dëmshpërblyer punonjësën ***** me pagën e 12 muajve (të shtohen edhe 6 muaj, pagesë), për shkak të vjetërsisë së saj në punë mbi 9 vjet, si nëpunëse civile.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia Përgjegjëse e institucionit dhe punonjësja *****.
3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **15 ditë**.

4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha